



Albanisch

Hyrja në kopshtin e fëmijëve — parakushtet nga pikëpamja e mjekut të shkollës dhe psikologut të shkollës

Fillimi i shkollimit në kopshtin e fëmijëve është një hap i rëndësishëm në jetën e një fëmije. Fillojnë të shkollohen ata fëmijë të cilët deri më 31 korrik i kanë mbushur katër vjet. Fëmijët zhvillohen në mënyra të ndryshme dhe jo gjithkund me të njëjtën shpejtësi – kopshti i fëmijëve i merr aty ku ata qëndrojnë dhe i përkrah individualisht.

Hap pas hapi

Gjatë viteve të para të jetës fëmijët fitojnë gjithnjë e më shumë besim për t'u shkëputur përkohësisht nga familja dhe për t'iu drejtuar me kuriozitet botës së jashtme. Grupet e lojës dhe çerdhet janë fusha të rëndësishme të të mësuarit – dhe të të ushtruarit. Deri në moshën 4 vjeçare shumica e fëmijëve i fitojnë parakushtet e nevojshme trupore, socio-emocionale dhe intelektuale, për të qenë të gatshëm dhe të hapur për sfidat e mjedisit të ri të kopshtit të fëmijëve dhe për t'i zotëruar mirë ato.

Parakushtet për fillimin e mirë në kopshtin e fëmijëve

Fëmija është i gatshëm për ta kaluar çdo ditë tërë paraditen në një grup më të madh të fëmijëve të së njëjtës moshë dhe të fëmijëve pak më të rritur, nën udhëheqjen e mësuesit të kopshtit të fëmijëve. Frymëzimet nga kopshti i fëmijëve i përkrahin hapat e



mëtejshëm zhvillimor në përshtatje me moshën. Kjo arrihet, nëse fëmija mund të përdorë të gjitha shqisat e tij gjatë lojërave të lira si dhe në lektionet e udhëhequra. Për këtë arsye mjekja e fëmijëve / mjeku i shtëpisë me rastin e kontrolleve katërvjeçare, kontrollon nëse fëmija sheh dhe dëgjon mirë ose nëse ka nevojë për ndihmë në të parë ose në të dëgjuar.

Në mënyrë që fillimi i kopshtit të fëmijëve të jetë i suksesshëm, fëmijët duhet t'i plotësojnë kryesisht këto parakushte. **Nuk janë nevojat individuale, por një pamje e përgjithshme e nivelit të zhvillimit i cili është vendimtar për gatishmërinë për kopshtin e fëmijëve**

Parakushtet trupore

- ▶ Fëmija i kopshtit në mëngjes është zgjuar dhe i aftë për të kuptuar, në mënyrë që të mund të marrë pjesë aktive në programin e kopshtit. Kjo ka si parakusht një gjumë të gjatë dhe të patrazuar gjatë natës.
- ▶ Ai nuk ka më nevojë për ushqim në shishe dhe ha mëngjes për të rifituar forcën.
- ▶ Ai mund ta bëjë në këmbë rrugën për në kopsht.
- ▶ Ai mund ta shpaketojë vetë ushqimin e lehtë të orës nëntë të cilin e ka sjellë me vete dhe ta hajë



Mirë të dihet: Ekspertët sot supozojnë se fëmijët zhvillohen më së miri dhe përkrahen e sfidohen më së miri, nëse ofertat e mjedisit përputhen me nivelin e zhvillimit të fëmijës.

atë.

- ▶ Ai e vëren se kur duhet të shkojë në tualet dhe me një ndihmë të vogël (p.sh. hapjen e pullës së pantallonave) mund të shkojë në mënyrë të pavarur në WC.
- ▶ Fëmija ka disa aftësi bazike si dhe disa shkathtësi në vrapim, kërcim, ngjitjen e shkallëve, por edhe në vizatim, prerje, larjen e duarve, pastrimin e hundës, veshjen dhe zhveshjen e rrobave dhe mbathjen e z bathjen e këpucëve.

Parakushtet sociale dhe emocionale

- ▶ Fëmija i kopshtit mund të ndahet gjatë tërë paraditës nga personat kujdestarë. Ai nuk ka nevojë për dado apo kujdestarë.
- ▶ Ai përpiqet të shprehë nevojat e tij në mënyrë të kuptueshme për të tjerët.
- ▶ Ai mundohet të marrë kontaktet me fëmijët e tjerë dhe mësuesit në mënyrë të përshtatshme.



- ▶ Ai i kupton rregullat dhe përpiqet t'i zbatojë ato.
- ▶ Ai mundohet që konfliktet t'i zgjidhë pa dhunë.
- ▶ Ka besim që të provojë sërish pas një dështimi.
- ▶ Ai mund të ngushëllohet.

Parakushtet intelektuale

- ▶ Fëmija i kopshtit vëzhgon dhe mund të ndjekë udhëzimet gjatë lojërave lëvizëse, gjatë punëdores dhe vizatimit.
- ▶ Ai reagon ndaj mësuesve dhe mund t'i kuptojë e t'i kryejë detyrat e thjeshta.
- ▶ Ai mund të qëndrojë gjatë lojës, mund të presë ose të presë zhvillimin e lojës.

Shkollimi i parakohshëm në kopshtin e fëmijëve

Ligji nuk lejon një hyrje të parakohshme në kopshtin e fëmijëve.

Shkollimi i mëvonshëm në kopshtin e fëmijëve

Një shkollim i mëvonshëm për shkak të gjendjes zhvillimore është rrallë në interes të fëmijës. Sepse si rregull, përparimet e dëshiruara në zhvillimin fëmijëror nuk ndodhin vetvetiu, por tek nëpërmjet të përkrahjes së qëllimshme. Kjo do të thotë se fëmija ka nevojë për përkrahje individuale gjatë kësaj kohe. Përveç kësaj fëmijët, zhvillimi i të cilëve mbetet më prapa se i bashkëmoshatarëve të tyre, shpesh janë deri në një vit më të moshuar, më të mëdhenj dhe më të fortë se sa

kolegët/et e tyre të të njëjtit vit të kopshtit, gjë që sjell jo rrallë vështirësi sociale dhe emocionale. Andaj për raste individuale duhet të shtrohet një kërkesë për kthim prapa tek autoriteti shkollor i rrethit. Mjeku/ja e shkollës ose psikologu/ia e shkollës mund të ftohet për një mendim të dytë. Në disa rrethe shkollore mund të kërkohej në mënyrë plotësuese një certifikatë mjekësore.

Kapërcimi/përsëritja e një viti i kopshtit të fëmijëve

Kopshti i fëmijëve zgjat zakonisht dy vjet. Për një numër të vogël të fëmijëve, zhvillimi intelektual ose personal i të cilëve e lejon/kërkon këtë, kalimi në shkollën fillore mund të ndodhë në raste përjashtuese edhe pas një viti, ose tek pas tre vjetësh.

Përkujdesja shkollore/ Përkujdesja pas shkollës

Për ta kaluar tërë ditën, duke përfshirë të ngrënit, në një grup të madh dhe me moshë të ndryshme të fëmijëve dhe pa prindërit, është një sfidë për fëmijët e moshës së kopshtit. Varësisht nga përvoja paraprake dhe personaliteti kjo mund të përjetohej si diçka frymëzuese ose edhe si diçka mbingarkuese. Lejini fëmijës suaj kohë që të përshtatet hap pas hapi me formën e re të përkujdesit.

Masat e veçanta pedagogjike

Masat e veçanta pedagogjike janë për shembull logopedia, përkrahja e veçantë pedagogjike ose

psikomotorika. Nëse një fëmijë ka nevojë që në fillim për masa të veçanta pedagogjike, atëherë mund të bëhet një kërkesë tek autoriteti shkollor i rrethit për ta shqyrtuar. Përndryshe nëse është e nevojshme kjo mund të diskutohet me prindërit edhe gjatë kohës së kopshtit.

Çfarë mund të bëjnë prindërit?

Prindërit e përkrahin fëmijën e tyre nëse e inkurajojnë atë të jetë i pavarur dhe besojnë në aftësinë e tij për të mësuar. Jepini atij faktin se përveç përjetimeve pozitive edhe konfliktet dhe dështimet janë pjesë e procesit mësimor. Një qëndrim i hapur ndaj mësuesve dhe shkollës që nga fillimi është një mbështetje e rëndësishme për zhvillimin shkollor të fëmijës.

Dialogu

Nëse keni ndonjë shqetësim kërkonit me kohë të bisedoni me mësuesin.

Varësisht nga nevoja mund të thirret enti mjekësor i shkollës ose enti psikologjik i shkollës, autoriteti përgjegjës i shkollës ose ekspertë të tjerë (si p.sh. mjeku/ja i/e fëmijës suaj, personat mbështetës të përfshirë ose terapeutët/et).

